



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

20.05.2013

Pranuar - Primenjë / Më Dëna			
Nr. i organit / Org. broj	Numri/Broj	Shtojat / Prilog	Vlera / Vrednost
01-013/425			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, nenit 36 pika d) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 14.05.2013, aprovon këtë:

V E N D I M
PËR SHPALLJEN ZONË ME INTERES TË PËRGJITHSHËM TË NGASTRAVE
KADASTRALE ME NR 1467-3,1468-0 DHE 1055-3 NË ZONËN KADASTRALE NË POZHERAN

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, SHPALLË zonë me interes të përgjithshëm ngastrat kadastrale me nr. 1467-3 shfrytëzimi aktual tokë ndërtimi, në vendin e quajtur "Fshat" në sipërfaqe prej 526 m², ngastra me nr. 1468-0, shfrytëzimi aktual, tokë ndërtimi, në vendin e quajtur "Fshat" në sipërfaqe prej 391 m² pronë e NBIQ "Agromorava" – Viti dhe ngastra me numër 1055 – 3 në sipërfaqe prej 347 m² në vendin e quajtur "Fshat" pronë e P.SH. Shkolla fillore "Bashkim Vllaznim" – Pozheran në Zonën Kadastrale në Pozheran për interesin e qytetarëve të fshatit Pozheran.

Neni 2

Ngastrat kadastrale të shpallura zonë me interes të përgjithshëm nga neni 1 i këtij Vendimi do të shërbejnë për nevojat e qytetarëve të fshatit Pozheran.

Neni 3


Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit,
2. Drejtorisë për Kadastër dhe
3. Arkivit



KRYESUESI I KUVENDIT
Skenderbe Hebibi